



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
REKTORATI

Simpozium ndërkombëtar për Vlerësimin dhe Misionin e Universiteteve.

Rektori i Universitetit të Gjirokastrës **Prof.dr. Bektash Mema** dhe Administratori i këtij Universiteti **z. Gentian Llogo** morrën pjesë në Simpoziumin Ndërkombëtar me titull “Vlerësimi dhe Misioni i Universiteteve në Perspektivën Europiane”, i organizuar prej Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani në bashkëpunim me Universitetin e Barit “Aldo Moro” dhe Universitetin e Foxha-s -Itali. Qëllimi i këtij simpoziumi ishte krahasimi i sistemeve të vlerësimit dhe akreditimit të universiteteve në kontekste të ndryshme kulturore dhe shkencore. Ky simpozium iu referua harmonizimit të sistemeve universitare në perspektivën e një kuadri europian për arsimin universitar, sipas procesit të Bolonjës. Zv. Ministri i Arsimit, Ervin Demo, përshëndeti këtë iniciativë dhe u shpreh se institucionet e Arsimit të Lartë janë duke u organizuar. “Ministria konstaton me kënaqësi se, organizimi i brendshëm, që ndahet në dy shtylla kryesore, në organizimin akademik dhe atë administrativ, është duke u përmbyllur brenda vitit 2018. Ligji ka parashikuar qartësisht, jo vetëm ndarjen, por edhe në harmonizimin e kësaj ndarje”. Në këtë simpozium e morën fjalën profesorë të njohur të universiteteve italiane, profesorë, rektorë dhe administratorë të universiteteve shqiptare të cilët shkëmbyen eksperiencat për një përjasje europiane të Arsimit të Lartë në Shqipëri.



